



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2021:187941

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06092531

**C.nr.1308/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh. T., F. M., L. H. dhe A. M., të gjithë nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Uvejs Gashi – avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës, më datë 19.08.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Sh. T., F. M., L. H. dhe A. M., të gjithë nga M., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditësit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 24.08.2018 deri më datë 17.04.2021, t'i kompensojë si në vijim:
- i.** Paditëses Sh. T për 372 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë të përgjithshme prej 340.27€ (treqind e dyzet euro e njëzet e shtatë cent);
  - ii.** Paditësit F. M., për 372 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë të përgjithshme prej 340.27€ (treqind e dyzet euro e njëzet e shtatë cent);
  - iii.** Paditëses L. H. për 372 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë të përgjithshme prej 340.27€ (treqind e dyzet euro e njëzet e shtatë cent);

- iv.** Paditëses A. M për 291 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë të përgjithshme prej 266.18€ (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e tetëmbëdhjetë cent).
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, që paditësve shumat si në pikën I të dispozitivit t'ua paguajë me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë, më datë 24.08.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve Sh. T., F. M., L. H. dhe A. M., të gjithë nga M., për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më datë 24.08.2018, respektivisht për 355 ditë pune, në shumë prej 324.73€ (treqind e njëzet e katër euro e shtatëdhjetë e tre cent), si e pabazuar.
- IV.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

### **A r s y e t i m i**

Paditësit Sh. T., F. M., L. H. dhe A. M., të gjithë nga M., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datë 24.08.2021, pranë kësaj gjykate kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit. Paditësit në padi kanë pretenduar se të njëjtit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “M.U.”, në fshatin B., në M., në pozitën e mësimdhënësve. Meqënëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditësve për kompensim në emër të shpenzimeve të udhëtimit, pavarësisht kërkesës së ushtruar nga paditësit, të njëjtit duke u mbështetur në dispozitën e nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, kanë kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë e tyre si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që paditësit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më datë 17.04.2021, t'i kompensojë si në vijim: paditësen Sh. T., për 38 muaj apo 727 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë prej 665.00€; paditësit F. M., për 38 muaj apo 727 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë prej 665.00€; paditëses L. H., për 38 muaj apo 727 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore në shumë prej 665.00€; dhe paditëses A. M., për 34 muaj apo 646 ditë pune, t'ia kompensojë

shumën prej 70% të biletës ditore në shumë prej 1,569.40€, të gjitha me kamatë ligjore deri në përmbushjen e detyrimit. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar por nuk i kanë specifikuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se për periudhën para datës 24.08.2018 padia e paditësve është parashkuar konform dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës, ndërsa për periudhën nga data 24.08.2018 deri më datë 24.08.2021, e paditura konsideron se paditësit nuk kanë bashkangjitur prova me të cilat vërtetohet se të njëjtit kanë krijuar shpenzime të udhëtimit për periudhën kohore për të cilën kërkojnë kompensimin pasi që të njëjtit nuk kanë bashkangjitur bileta të udhëtimit dhe as vërtetime të cilat provojnë periudhën e saktë gjatë së cilës paditësve u janë shkaktuar shpenzime të udhëtimit. Në fund ka theksuar se paditësit gabimisht kanë llogaritur lartësinë e kompensimit të kërkuar për shkak të përfshirjes në llogaritje edhe të kërkesave të parashkuara, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve dhe provave të bashkangjitura nga ana e tyre, gjykata konstatoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritore pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës së nenit 398 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se janë në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “M.U.”, në fshatin B. në M., në pozitën e mësimitdhënësve. Kjo u provua edhe përmes kontratave të punës së paditësve siç janë: kontrata e punës për paditësen Sh. T. me nr.prot.9/2021 e datës 03.03.2021; kontrata e punës për paditësin F. M. me nr.prot. 74/16 e datës 01.09.2016; kontrata e punës për paditësen L. H. me nr.prot.72/17 e datës 04.09.2017 dhe kontrata e punës për paditësen A.a M. me nr.prot.54/19 e datës 01.11.2019.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse rezultoi të jetë nëse paditësve u takon kompensimi në emër të shpenzimeve të udhëtimit, respektivisht provueshmëria se atyre u takon një kompensim i tillë.

Nga kërkesa me nr.07-120/08-0045728/21 e datës 10.06.2021, rezulton se paditësit para se të kërkoj mbrojtje gjyqësore në gjykatë, i janë drejtuar me kërkesë të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Nga kontrata e punës për paditësen Sh. T.me nr.prot.9/2021 e datës 03.03.2021, rezulton se paditësja në fjalë ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me status të përkohshëm, duke filluar nga data 01.03.2021 deri më datë 31.08.2021.

Nga kontrata e punës për paditësin F.M. me nr.prot. 74/16 e datës 01.09.2016, rezulton se paditësi në fjalë ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me status të përhershëm duke filluar nga data 01.09.2016.

Nga kontrata e punës për paditësen L. H. me nr.prot.72/17 e datës 04.09.2017, rezulton se paditësja në fjalë ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me status të përhershëm duke filluar nga data 04.09.2017.

Nga kontrata e punës për paditësen A. M. me nr.prot.54/19 e datës 01.11.2019, rezulton se paditësja në fjalë ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me status të përkohshëm, duke filluar nga data 02.09.2019.

Nga vërtetimi me nr.prot.9/21 i datës 07.06.2021, i lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) “M. U.”, në B., në M., gjykata vërtetoi se paditësja Sh. T.për periudhën kohore nga data 17.04.2017 deri më datë 18.04.2021 ka gjithësej 727 ditë pune në këtë institucion arsimor.

Nga vërtetimi me nr.prot.13/21 i datës 27.05.2021, i lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) “M. U.”, në B., në M., gjykata vërtetoi se paditësi F. M. për periudhën kohore nga data 17.04.2017 deri më datë 18.04.2021 ka gjithësej 727 ditë pune në këtë institucion arsimor.

Nga vërtetimi me nr.prot.15/21 i datës 07.06.2021, i lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) “M. U.”, në B., në M., gjykata vërtetoi se paditësja L.H. për periudhën kohore nga data 17.04.2017 deri më datë 18.04.2021 ka gjithësej 727 ditë pune në këtë institucion arsimor.

Nga vërtetimi me nr.prot.16/21 i datës 07.06.2021, i lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) “M. U.”, në B., në M., gjykata vërtetoi se paditësja A. M. për periudhën kohore nga data 01.10.2017 deri më datë 18.04.2021 ka gjithësej 646 ditë pune në këtë institucion arsimor.

Nga vërtetimi i datës 22.04.2021, i lëshuar nga Agjencioni Turistik “B. T.”, me adresë në Mitrovicë, sipas kërkesës së paditëses, gjykata vërtetoi se paditësja Sh. T. ka shfrytëzuar transportin urban në relacionin Mitrovicë-fshati B., për periudhën kohore nga data 01.04.2017 deri më datë 18.04.2021, me ç’rast për 38 muaj apo 727 ditë pune, e njëjta ka paguar biletë mujore në shumë prej 25.00€, dhe atë në vitin 2017 ka krijuar shpenzime të udhëtimit për 7 muaj apo 144 ditë; në vitin 2018 për 10 muaj apo 185 ditë; në vitin 2019 për 10 muaj 186 ditë; në vitin 2020 për 7 muaj apo 140 ditë dhe në vitin 2021 për 4 muaj apo 72 ditë.

Nga vërtetimi i datës 22.04.2021, i lëshuar nga Agjencioni Turistik “B. T.”, me adresë në M., sipas kërkesës së paditësit, gjykata vërtetoi se paditësi F. M. ka shfrytëzuar transportin urban në relacionin M.-fshati B., për periudhën kohore nga data **01.04.2017**, me ç’rast për 38 muaj apo 727 ditë pune, i njëjti ka paguar biletë mujore në shumë prej 25.00€, dhe atë në vitin 2017 ka krijuar shpenzime të udhëtimit për 7 muaj apo 144 ditë; në vitin 2018 për 10 muaj apo 185 ditë; në vitin 2019 për 10 muaj 186 ditë; në vitin 2020 për 7 muaj apo 140 ditë dhe në vitin 2021 për 4 muaj apo 72 ditë.

Nga vërtetimi i datës 22.04.2021, i lëshuar nga Agjencioni Turistik “B. T.”, me adresë në M., sipas kërkesës së paditëses, gjykata vërtetoi se paditësja L. H. ka shfrytëzuar transportin urban në relacionin M.-fshati B., për periudhën kohore nga data 01.04.2017 deri më datë 18.04.2021, me ç’rast për 38 muaj apo 727 ditë pune, e njëjta ka paguar biletë mujore në shumë prej 25.00€, dhe atë në vitin 2017 ka krijuar shpenzime të udhëtimit për 7 muaj apo 144 ditë; në vitin 2018 për 10 muaj apo 185 ditë; në vitin 2019 për 10 muaj 186 ditë; në vitin 2020 për 7 muaj apo 140 ditë dhe në vitin 2021 për 4 muaj apo 72 ditë.

Nga vërtetimi i datës 22.04.2021, i lëshuar nga Agjencioni Turistik “B. T.”, me adresë në M., sipas kërkesës së paditëses, gjykata vërtetoi se paditësja A. M. ka shfrytëzuar transportin urban në relacionin M.-fshati B., për periudhën kohore nga data 01.10.2017 deri më datë 18.04.2021, me ç’rast për 34 muaj apo 646 ditë pune, e njëjta ka paguar biletë mujore në shumë prej 25.00€, dhe atë në vitin 2017 ka krijuar shpenzime të udhëtimit për 3 muaj apo 63 ditë; në vitin 2018 për 10 muaj apo 185 ditë; në vitin 2019 për 10 muaj 186 ditë; në vitin 2020 për 7 muaj apo 140 ditë dhe në vitin 2021 për 4 muaj apo 72 ditë.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Agjencioni Turistik “A. T.”, me adresë në M., rezulton se paditësja A. M. ka shfrytëzuar këtë transport në relacionin K. i V. – M.dhe anasjelltas, për periudhën

kohore nga data 01.10.2017 deri më datë 18.04.2021, dhe bileta e udhëtimit për një relacion ka qenë 0.50€.

Nga çertifikata e vendbanimit me nr.serik B 10324231, e datës 19.05.2021, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, rezulton se paditësja Sh. T., vendbanimin e ka në Mitrovicë, Rr.”H. M. S. nr..”.

Nga çertifikata e vendbanimit me nr.serik E 25151984, e datës 25.05.2021, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, rezulton se paditësi F. M., vendbanimin e ka në . Rr.”E. Ç.”.

Nga çertifikata e vendbanimit me nr.serik B 10324234, e datës 19.05.2021, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, rezulton se paditësja L. H., vendbanimin e ka në M., Rr.”M.T.”, 0/1, nr.18.

Nga çertifikata e vendbanimit me nr.serik B 10325670, e datës 26.05.2021, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, rezulton se paditësja A. M., vendbanimin e ka në fshatin K.i V., në M..

Provave materiale të lartcekura, gjykata u’a fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës së nenit 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*, dhe par.2, i cili përcakton se: *“Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike.”*.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), me datë 18.04.2017 dhe ajo më datë 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën e nenit 35 par.5 të Kontratës së lartcekur, ku është përcaktuar se: *“Punonjësve*

*arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.*

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe atë Nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësit janë legjitimuar të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqësve, në kuptim të dispozitës nga neni 245 i Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se: *“Kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Sa i përket provueshmërisë së kërkesëpadisë, gjykata nga provat e administruara vërtetoi se paditësit e kanë vendbanimin në Mitrovicë, respektivisht paditësja Ambulena Mustafa e ka vendbanimin në fshatin Kçiq i Vogël, në Mitrovicë, ndërsa vend punimin të gjithë paditësit e kanë në fshatin Bajgorë, në Mitrovicë dhe për faktin se vend punimi i paditësve ka qenë jashtë vendbanimit të tyre, rezulton se të njëjtit për çdo ditë të pranisë në punë kanë udhëtuar brenda vendbanimit të komunës përkatëse ku kanë punuar, në relacionet Mitrovicë – Bajgorë, respektivisht paditësja Ambulena Mustafa në relacionin Kçiq i Vogël – Mitrovicë dhe Mitrovicë Bajgorë, dhe anasjelltas duke krijuar secili shpenzime mujore në lartësi prej 25.00€, andaj edhe u’a njohu kompensimin duke vendosur si në pikën I ii) të dispozitivit, duke bërë llogaritjen në atë mënyrë që ditët e kaluara në punë të paditësve i ka shumëzuar me 70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionet ku të njëjtit kanë udhëtuar, duke u’a njohur kompensimin si në pikën I të dispozitivit.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditëses A. M., gjykata gjen se e njëjta nuk ka arritur të provojë shpenzimet e krijuara për udhëtim në relacionin K. i V. – M. dhe anasjelltas, pasi që vërtetimit të lëshuar nga agjencioni turistik, të cilin paditësja i’a ka bashkangjitur padisë, gjykata nuk i’a fali besimin pasi që i njëjti nuk ishte i hartuar në formë të rregullt, respektivisht nuk përmbante datë të protokollimit dhe as datë të lëshimit, andaj edhe llogaritjen e kompensimit për këtë paditëse gjykata e bëri në atë mënyrë që ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me

70% të çmimit të biletës së trafikut urban në relacionin M.-fshati B., duke i'a njohur kompensimin si në pikën I iv) të dispozitivit.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimin e të paditurës se kërkesa e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit është parashkruar, dhe gjeti se një pretendim i tillë është pjesërisht i bazuar pasi që me dispozitën e nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa me dispozitën e nenit 342 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e që në rastin konkret paditësit kanë kërkuar që t’u kompensohen shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më datë 17.04.2021, ndërsa kërkesën për kompensim e kanë bërë më datë 24.08.2021, që nënkupton se kërkesa e tyre për periudhën para datës 24.08.2018 është parashkruar, dhe atë për 355 ditë pune për secilin paditës veç e veç, në shumë prej 324.73€, andaj për këto arsye gjykata vendosi që kërkesëpadinë e paditësve për këtë pjesë ta refuzoj si të pabazuar, duke vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 të kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se: *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Në këtë pjesë gjykata mori parasysh edhe pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se paditësit nuk kanë arritur që të provojnë shpenzimet e krijuara të udhëtimit, por të njëjtat i gjeti si të pabazuara pasi që paditësit me provat e bashkangjitura siç janë kontratat e punës, kanë provuar marrëdhënien e tyre të punës me të paditurën, pastaj me vërtetimet e lëshuara nga institucioni arsimor me të cilin kanë themeluar marrëdhënie pune kanë provuar ditët e pranisë në punë për periudhën kohore për të cilën kanë kërkuar kompensimin e me të cilat vërtetime janë në përputhje edhe vërtetimet e lëshuara nga agjencionet turistike me të cilat



paditësit kanë udhëtuar për të shkuar në vendin e tyre të punës, e pastaj këto të fundit janë në përputhje me certifikatat e vendbanimit për paditësit, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

Poashtu nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësit kanë bërë kërkesë pranë të paditurës për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo e paditura nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të paditësve, duke rënë kështu në vonesë në përmbushjen e detyrimit.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, sipas së cilës përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, më datë 24.08.2021.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 450 lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, pasi që palët ndërgjyqëse pavarësisht se i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës, të njëjtat nuk i kanë specifikuar.

Nga sa u tha më lart e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr.1308/2021 më datë 19.08.2024**

**G j y q t a r j a**

\_\_\_\_\_  
**Vlerona Maliqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:187941  
Datë: 27.08.2024  
Numri i dokumentit: 06092531